



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Autoriteti Kombëtar Për Certifikimin Elektronik**

---

**UDHËZIM**  
**MBI PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT DHE**  
**VULAVE ELEKTRONIKE**

---



**Udhëzim nr.4**  
**Versioni 4.1**  
**Buletini 2016**



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK**

**UDHËZIM**

**Nr. 4 , Datë 22.02.2016**

**MBI PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT DHE VULAVE ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 107/2015, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, VKM 69, 27.01.2016 “Për miratimin e Rregullores për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik,

**UDHËZON**

Të gjithë Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar, (OKSHB) për ofrimin e vulave elektronike dhe indentifikimin elektronik duhet të përmbushin kërkesat e mëposhtme:

1. Për pajisjen e personave fizik, me identifikim elektronik, OKSHB, kryen saktë identifikimin fillestar të aplikuesëve, nëpërmjet dokumentit zyrtar të identifikimit, që paraqet aplikuesi dhe dokumenton procedurën e pranuar nga të dy palët. Ky kriter është i zbatueshëm edhe për shtetasit e huaj, rezidentë në RSH.
2. Për pajisjen e personave juridik, me vulë elektronike OKSHB, kryen saktë identifikimin fillestar të aplikuesëve, nëpërmjet dokumentit zyrtar të identifikimit, dokument zyrtar që vërteton numrin e NIPT-it dhe vërtetim/autorizim përkatës, që vërteton përfaqësimin e personit juridik.

3. Garanton, se mjetet e identifikimit elektronik dhe ato të gjenerimit të vulës elektronike, janë të dizenuara në mënyrë të tillë, që vetëm mbajtësi i tyre ka akses dhe përdorim mbi to; janë të mbrojtura nga duplikimi dhe ndërhyrje e manipulime fizike. Ato duhet të garantojnë lidhjen me subjektin duke përdorur të pakten dy nga tre faktorët e autentifikimit si më poshtë:
  - a) subjekti duhet të demonstrojë zotërimin e tij
  - b) subjekti duhet të demonstrojë njohjen e tij
  - c) subjekti demonstron se zotëron attribute fizike (*finger print, retina, etj*)
  
4. Garanton me transparencë të plotë dhe dokumenton procesin i lëshimit, dorëzimit dhe aktivizimit të mjeteve të identifikimit elektronik dhe ato të gjenerimit të vulave elektronike, të cilat duhet t'i dorëzohen vetëm zotëruesit të tyre.
  
5. Krijon mekanizma autentifikimit duke garantuar se:
  - a. Lëshimi i të dhënave të identifikimit personal paraprihet nga një verifikim i besueshëm i vlefshmërisë së mjeteve të identifikimit elektronik nëpërmjet një autentifikimi dinamik, i cili garanton një provë elektronike, sa herë kërkohet, që subjekti ka nën kontroll të dhënat e autentifikimit, i cili ndryshon me secilin proces të autentifikimit ndërmjet subjektit dhe sistemit, që verifikon identitetin e tij.
  - b. Në rastet kur të dhënat e identifikimit personal ruhen si pjesë e mekanizmave të autentifikimit, ky informacion ruhet në mënyra të tillë, që të mbrohet kundrejt kompromentimit, përfshirë tentativat e modifikimeve *offline*.
  - c. Implementon kontrole sigurie për verifikimin e mjeteve të identifikimit elektronik, në mënyrë që veprime si hamendësimi i kodeve të aksesit, përgjimi, apo manipulimi i kanaleve të komunikimit, të komprometojnë apo simulojnë rezultatet e gjeneruara nga mekanizmat të autentifikimit.
  
6. OKSHB, duhet të disponojë një shërbim elektronik për të publikuar dhe shpërndarë njoftimet ndaj zotëruesve, në lidhje me të gjitha kushtet e përdorimit, përgjegjësitë e palëve, përfshirë këtu edhe çdo limitim të shërbimit apo përdorimit të shërbimeve. Ky shërbim duhet të përfshijë edhe një politikë të privatësisë;
  - a. Procedura dhe politika duhet të implementohen në mënyrë, që të sigurojnë që përdoruesit e shërbimit të njoftohen pa vonesa për ndryshime në përkufizimet e shërbimit apo në terma të tjera të kushteve të përdorimit dhe politika të privatësisë për shërbimin e specifikuar;
  - b. Politika dhe procedura duhet të implementohen në mënyrë, që të përgjigjen plotësisht dhe në mënyrë korrekte ndaj çdo kërkesë për informacion nga ana e zotëruesve.

7. OKSHB duhet të parashikojë kontrolle teknike për të menaxhuar risqet ndaj sigurisë së shërbimeve, mbrojtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshërisë së informacionit të procesuar sipas kushteve të mëposhtme:
  - a. Kanalet e komunikimeve elektronike, të përdorura për shkëmbimin e të dhënave personale apo informacionit sensitiv, duhet të jenë të mbrojtura nga përgjimet, manipulimi apo regjistrimi;
  - b. Aksesit ndaj pajisjeve dhe materialeve kriprografike, të cilat përdoren për lëshimin e mjeteve të identifikimit dhe autentifikimit, si dhe mjeteve të gjenerimit të vulave elektronike, limitohen vetëm ndaj roleve dhe aplikacioneve, të cilat domosdoshmërisht kanë nevojë për akses ndaj tyre. Kontrollat e aksesit ndaj materialeve të tilla, nuk duhet të ruhen asnjëherë në tekst të lexueshëm;
  - c. Procedura duhet të garantojë nivelin e sigurisë ndaj ndryshimeve, risqeve dhe incidenteve të mundshme mbi të;
  - d. Çdo medium ruajtjeje të të dhënave personale, kriptografike apo informacioneve të tjera sensitive, ruhen, transportohen dhe shkatërrohen në mënyrë të sigurt.
  - e. Materialet kriptografike sensitive, të cilat përdoren për lëshimin e mjeteve të identifikimit dhe autentifikimit dhe mjeteve të gjenerimit të vulave elektronike, duhet të mbrohen ndaj ndërhyrjeve fizike në to.
  
8. Në rastin e implementimit të vulës elektronike për shërbime publike elektronike:
  - a. formati vizual i vulës në dokumentin e përfituar nga shërbimi elektronik, duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

Paraqitja grafike e vules fizike te institucionit	Emri i Institucionit lëshues
	Data dhe ora e vulosjes - sipas vulës kohore - timestamp
	Nr. serial të dokumentit të vulosur – i lidhur me kodin <i>dydimensional</i> , në rast se një i tillë i afishohet dokumentit)
Shënim:	Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (emri i institucionit përkatës)

- b. Forma e vulës elektronike duhet të jetë drejtkëndore dhe përmasat e saj nuk duhet të kalojnë 40% të gjerësisë së dokumentit apo 30% të lartësisë së tij (shembull: për formatin A4 – 84mm horizontalisht dhe 89mm vertikalisht);
- c. Vula elektronike vendoset në pjesën e fundit, të faqes së fundit të dokumentit.